



Green School Sh.p.k

Shkolla 9-vjecare

Eurolingua

PAKETË INFORMATIVE MBI ASPEKTE TË NDRYSHME TË FUNKSIONIMIT TË SHKOLLËS

Misioni: Në shkollën tonë ne e kemi **mision** të krijojmë nxënës që bëhen aktivistë në përmirësimin e së ardhmes, sepse **e ardhmja** u përket atyre.

Institucioni

Institucioni arsimor "Green School", është një institucion jo publik i cili ofron arsimin 12- vjeçar nga cikli parashkollor deri në klasën e nëntë. Ky institucion është i hapur për të gjithë fëmijët e kësaj moshe, pa dallim përkatësie gjinore, fetare apo etnike. "Green School" do të punojë në bazë të programeve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës si dhe programeve tjera shtesë në përputhje me metodologjinë e shkollës.

- Shkolla siguron kushtet optimale të godinës së saj ku do të ushtrohet aktiviteti.
- Shkolla i jep çdo prindi në prag të fillimit të vitit shkollor listën e mjeteve personale që çdo fëmijë duhet të sjellë me vete.
- Shkolla do të jetë e hapur dhe do të zbatojë pushimet sipas kalendarit shkollor të miratuar nga MASH.
- Për çdo rast aksidenti, sëmundje apo dëmtime të fëmijeve shkolla njofton menjëherë prindërit.
- Shkolla mban në përdorim një kuti të ndihmës së shpejtë në raste dëmtimesh të ndryshme. Kjo në marrëveshje paraprake me prindërit.
- Shkolla afishon çdo të hënë menunë e javës.
- Shkolla është e hapur të mirëpresë çdo mendim që është në të mirë të procesit të rritjes dhe edukimit të fëmijëve.

Orari

- Mësimi fillon në orën 8.30 dhe mbaron në orën 15.30, nga e hëna në të premte.
- Shkolla zhvillon çdo ditë gjashtë orë mësimore. Ora e mësimit zgjat **60 min**, kohë në të cilën përfshihen: kontrolli i njohurive, marja e temës së re dhe përforsimi i temës së re me anë të ushtrimeve dhe metodave të tjera alternative.
- Brenda këtij orari bëhen dy pushime të alternuara midis orëve.
- Prindërit janë të lutur të sjellin fëmijët në oraret e caktuara për të mos prishur mbarëvajtjen e mësimimit.
- Për çdo mungesë apo vonesë, prindërit duhet të lajmërojnë në kohë sekretarinë e shkollës.



Green School Sh.p.k

Shkolla 9-vjecare

Eurolingua

- Për një funksionim sa më të mirë të procesit mësimor, prindërit janë të ndaluar të futen në ambientet mësimore gjatë orarit mësimor.
- Prindërit janë të mirëpritur për të vizituar shkollën, por duhet të njoftojnë në avancë (24 orë përpara), për kohën dhe arsyen.

Komunikimi:

Për çështje të lidhura me mbarvajtjen mësimore, sociale dhe emocionale të fëmijës suaj linja e parë e komunikimit është mësuesi. Nëse mësuesi ju sygjeron që të komunikoni me drejtuesit e shkollës jeni të mirepritur. Për çështje administrative, transporti apo aspekte të tjera jo të lidhura drejtpërdrejt me mësimdhënien mund të komunikoni me personat përkatës në administratë me numrat e kontaktit në dispozicionin tuaj.

Pritshmëritë për sjelljen e nxënësve në shkollë

- Shkolla krijon një ambjent ku nxënësit të arrijnë maksimumin e tyre në rezultate dhe të sillen me respekt për veten, njëri tjetrin dhe shkollën.
- Kur nxënësit kanë sjellje të ashpra të përsëritura që dëmtojnë komunitetin tonë të shkolla komunikon me familjen dhe masa disiplinore ndiqen në varësi të cdo rasti.
- Shkolla ruan të drejtën të përjashtojë nxënësin/nxënësen si përpjekje të fundme për të ruajtur një komunitet psikologjikisht të shëndetshëm për të gjithë.

Kodi i veshjes dhe mjete personale:

- Nxënësit duhet të kenë një kod veshje të përshtatshme për të qënë aktivë fizikisht përgjatë ditës.
- Fundet apo pantallonat, nuk mund të jenë mbi gjatësinë e gjurit, bluzat këshillohet të kenë dekolte të mbyllur e mëngë të shkurtra.
- Nxënësit mund të veshin bizhu të thjeshta dhe pa përmbajtje simbolesh raciste, pijesh alkolike apo droge.
- Telefona, mjete të tjera teknologjike të cilat nuk kanë lidhje me aktivitetet shkollore, apo sende me vlerë është e këshillueshme të dorëzohen në sekretarinë e shkollës. Në rast dëmtimi apo humbje, shkolla nuk mban përgjegjësi.

Organizime ditëlindjesh:

Nëse prindërit dëshirojnë që ta festojnë në shkollë ditëlindjen e fëmijës, mund të sjellin vetëm një tortë, qiri, pjata e pirunj. Pije me gaz apo energjike nuk lejohen. Organizimi nuk mund të zgjasë më shumë se njëzet minuta.